

Tiranë, 04.01.2024

Komente dhe sugjerime mbi dokumentin

UDHËRRËFYESI PËR FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE

Koment i përgjithshëm

Meriton vlerësim fakti se dokumenti është në konsultim publik dhe është përpjekje e parë për të prezantuar një dokument të tillë. Nga faqja e konsultimit mungon një dokument shpjegues të synimeve, mjedisit, treguesve dhe pritshmërive reale, gjithsesi ne gjykojmë mbi dokumentin e vetëm të ofruar (udhëzuesin). Në përgjithësi përshtypja jonë është se dokumenti është i mbingarkuar nga shprehje standarde, përsëritje, angazhime deklarative, shumica të pamatshme dhe ka elementë të veçantë që nuk qëndrojnë as në aspektin kohor.

Gjithsesi në respekt të konsultimit dhe rolit tonë si organizatë e shoqërisë civile për t'iu përgjigjur mundësisë së shprehjes së opinioneve, po ju dërgojmë disa nga mendime / vlerësime tona konkrete;

- 1. Lidhur me masat e përcaktuara në pikën 1, "Miratimi i një kornize ligjore që adreson rekomandimet e pazbatuara të OSBE-së përmes një procesi konsultimi të hapur dhe gjithëpërfshirës, brenda vitit 2024"*

Komenti: ISP mendon se është angazhim deklarativ, jo efektiv. Komisioni i Venecias përcakton detyrimin që disa ndryshime ligjore (sistemi zgjedhor, zonat zgjedhore, administrimi i përgjithshëm zgjedhor, formula, etj) të bëhen jo më vonë se një vit përpara zgjedhjeve, pra duhen jetësuar para maj/qershor 2024 dhe jo "brenda vitit 2024" siç theksohet aty. Po ashtu, angazhimi "Votimi i shtetasve shqiptarë me vendbanim të përhershëm jashtë territorit" është detyrim kushtetues që aktet të dalin përpara datës 14 janar 2024, dhe nuk mund të thuhet se dalin deri në 2025 siç është cituar në dokument. Tek "performanca" citohet "zbatimin e Vendimit të Gjykatës Kushtetuese. nr.38, datë 09.12.2022", kur afati i opinioneve për këtë dokument përfundon me 24 janar 2024, pra 10 ditë pasi skadon afati kohor i përcaktuar nga GJK.

- II. Lidhur me angazhimin “mundësimi i votimit elektronik në një shkallë më të gjerë për të siguruar transparencë dhe kontroll më të madh publik mbi zgjedhjet brenda vitit 2025”.

Komenti: ISP vlerëson se është vendim politik dhe përbën një prej pikave thelbësore të debatit mbi reformën zgjedhore, por ende nuk ka bisedime dhe as konsensus. Dokumenti nuk mund ta shpreh si angazhim dhe masë një ide/premtim që nuk është përgjegjësi dhe as vendimmarrje e qeverisë apo KQZ.

- III. Lidhur me angazhimin 1.2 mbi mediat në fushatë elektorale thuhet “përfshirë monitorimin e mediave sociale të miratuar brenda vitit 2024, pas një procesi konsultimi publik”.

Komenti: ISP vlerëson se nuk ofrohet asnjë mekanizëm dhe e dhënë sesi mund të zbatohet kjo. Në Shqipëria nuk ka legjislacion për mediat sociale në fushatë elektorale dhe AMA nuk ka përgjegjësi ligjore në këtë drejtim.

- IV. Lidhur me masat e përcaktuara në pikën 2, “Amendimi i Kodit të Sjelljes së deputetëve, për të futur detyrimin që takimet e deputetëve dhe stafit të tyre me OSHC-të dhe lobistët të zhvillohen vetëm me ata që janë të regjistruar në Regjistrin e Transparencës në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Komisionit të datës 31 janar 2018 mbi Kodin e Sjelljes”.

Komenti: ISP vlerëson se propozimi nuk sjell rritje të transparencës dhe as hapje të parlamentit. Organizata si ISP janë pjesë e këtij regjistri dhe gjatë 3 viteve të fundit ka marrë ftesë për vetëm 4 akte ligjore. Regjistri ka të dhëna për organizata që *de facto* nuk kanë aktivitet, nuk ekzistojnë, si dhe ka raste kur janë përfshirë në regjister për shkak të nevojës së palëve ose Kuvendit për të sponsorizuar organizata “pro” mazhorancave të radhës.

Rekomandim: Masë më efektive do të ishte reformimi i Regjistrin, verifikimi real i organizatave dhe lidhja e tyre me aktivitetin parlamentar, parandalimi i konfliktit të interesit, një sistem funksional konsultimi të vazhdueshëm, si dhe reformimi përmes legjislacionit i konceptit “lobim” dhe “lobues”. Organizatat e shoqërisë civile në konceptin europian nuk janë subjekte lobuese, por kryesisht monitoruese dhe sensibilizuese. Lobues janë kryesisht organizata të karakterit financiar ose përfitues në sektorë të ndryshëm, si dhomat e biznesit, sindikatat, bashkimet ekonomike, shoqatat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, organizata ndërkombëtare me fokus lobimin, etj.

- V. Lidhur me propozimin për ndryshimin e Rregullores së Kuvendit për të zgjeruar zbatimin e Post Kontrollit të ligjshmërisë jo vetëm për ligjet e përafuara me *acquis* të BE-së, por edhe në aktet normative që kanë fuqinë e ligjit deri në vitin 2026;

Komenti: ISP vlerëson se angazhimi nuk sjell ndryshim cilësor dhe aktualisht këtë proces nuk e pengon rregullorja. Është funksion kushtetues i Kuvendit mbikëqyrja parlamentare, përfshirë jetësimi i ligjeve që miraton. Aktet normative janë vetëm një pjesë e problemit, ligjet e personalizuar janë shumë më shqetësuese, ndërkohë që sugjerim ynë është që

kontrolli postlegjislativ të bëhet për çdo akt parlamentar (zakonisht Kuvendi miraton jo më shumë se 10 ligje të plota në vit), pjesa kryesore vendimmarrëse e Kuvendit janë vendimet, ratifikimet, rezolutat, amendimet ligjore, pra jo ligjet e plota.

VI. Tek kategoria lidhur me Kuvendin (2.1) pjesa më e madhe e angazhimeve, masave etj;

Komenti: ISP vlerëson se ato janë deklarative, nuk janë të matshme, nuk kanë objekt konkret dhe nuk kanë afate që janë në përputhje edhe me legjislacionin aktual. Për shembull, angazhimi “Rritja e pjesëmarrjes së OSHC-ve dhe grupeve të interesit në mbledhjet e komisioneve parlamentare gjatë procesit ligjbërës dhe mbikëqyrës si dhe gjatë ushtrimit të funksionit zgjedhor të Kuvendit. (Afati i fundit: 2024-2030), është frazë e përdorur në të gjitha dokumentet strategjike të 15 viteve të fundit, por pa zbatim real dhe pa tregues real funksionaliteti.

Rekomandim: Një propozim real do të ishte, për çdo ligj komisionet janë të detyruara të vlerësojnë rekomandimet dhe vlerësimet që vijnë nga shoqëria civile e regjistruar në Regjistrin e OJF në Kuvend dhe se kërkesat për seancë dëgjimore nuk refuzohen, dhe se rekomandimet e ardhura i bashkëngjiten dokumenteve të Kuvendit që shkojnë në seancën plenare, etj.

VII. Lidhur me angazhimin “Disponueshmëri më në kohë dhe më miqësore për përdoruesit e dokumentacionit zyrtar parlamentar për shoqërinë civile, median, palët e tjera të interesuara dhe publikun..”

Komenti: ISP vlerëson se janë gjithashtu fraza deklarative. Në praktikën tonë ne porositim dokumente në Kuvend, për të cilat paguajmë dhe të cilat do të duhet të ishin publike, si p.sh., CV e kandidatëve që konkurrojnë për poste të ndryshme të zgjedhur nga Kuvendi. Rekomandim: A mund të sigurohet që Kuvendi të japë akses të plotë në dokumentacion për aktet që ndërmerr, CV e kandidatëve që zgjidhen në funksione prej Kuvendit, për stafin parlamentar, për nismat parlamentare, për vendimmarrjet në strukturat drejtuese, për procesin konsultues që zhvillohet etj? Kjo po do të ishte ndryshim cilësor për transparencë.

VIII. Lidhur me angazhimin “Organizimi i proceseve të zgjedhjeve/emërimeve të kryetarëve dhe anëtarëve të institucioneve të pavarura sipas afateve ligjore dhe vendeve vakante të krijuara, pa vonesa dhe duke siguruar zbatimin e parimeve të paanshmërisë, pavarësisë dhe transparencës. Afati: 2024-2030”.

Komenti: ISP vlerëson se duket utopike dhe deklarative. Kuvendi aktual sapo mbylli vitin kalendarik me 22 vende vakante, disa prej të cilave prej më shumë se një viti (Avokati i Popullit, etj). Si do të jetësohet ky premtim? Mungojnë mekanizmat e garancisë

- IX. Lidhur me disa masa/angazhime si “Përmirësimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit mbi ekzekutivin duke shtuar përdorimin e instrumenteve të kontrollit nga deputetët (pyetje, interpelanca, seanca dëgjimore në komisionet parlamentare, mocione, vizita, etj.) si dhe duke rritur aktivitetet e nënkomisioneve parlamentare. Afati: 2023-2030” apo “Ushtrimi sistematik i funksionit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj veprimtarisë së qeverisë, lidhur me zbatimin e ligjeve dhe politikave, nëpërmjet: Përdorimit më intensiv të interpelancave, pyetjeve, mocioneve për debat në seancat plenare, seancave dëgjimore në komisionet parlamentare, kërkesave për informacion, etj. (Afati: 2024-2030)” apo “Rritja e përdorimit të instrumenteve të kontrollit nga deputetët (pyetje, interpelanca, seanca, mocione, vizita, etj.) (Afati: 2024-2030)”

Komenti: ISP vlerëson se në thelb janë të njëjta, përsëritje dhe duke se janë vendosur për të rritur numrin formal të angazhimeve/masave. Për më tepër, kjo ndërvohet nga vullneti i vetë deputetëve dhe nuk mund të realizohet në këtë formë të paraqitur, ndërkohë që koncepti “komisione hetimore” që është më i ulët në hierarki sesa “mocione” nuk është përfshirë në asnjërën kategori. Termi “komisione parlamentare” nuk do të thotë “komisione hetimore”, janë dy koncepte dhe emërtesa të ndryshme.

- X. Lidhur me angazhimin tek “integriteti”, “për luftimin e rryshfetit të zyrtarëve të huaj publikë nëpërmjet ratifikimit..”

Komenti: ISP vlerëson se nuk është prioritet dhe problem kryesor për ne, - problem kryesor nuk janë zyrtarët e huaj, por konflikti i interesit në vendimmarrje nga deputetët dhe mungesa e një mekanizmi të qartë raportues, parandalues, monitorues dhe reagues në këto raste.

- XI. Lidhur me propozimin “Raporti vjetor i Avokatit të Popullit publikohet para se të prezantohet në Kuvend”

Komenti: ISP vlerëson se jetësimi i tij nuk sjell ndonjë ndryshim cilësor. Shumica e institucioneve publikojnë raportet para se të diskutohen në Kuvend dhe nuk reflektojnë ndonjë variant final mbi kritikën apo diskutimet që shkarkojnë këto raporte në komisione ose në seancat plenare. Pra nuk janë raporte ndëraktive, por formale, rutinore, statistikore dhe si të tilla, nuk e përmbushin pritshmërinë publike dhe as nevojat e parlamentit për të mbikëqyrur me cilësi aktivitetin e institucioneve të pavarura.

- XII. Lidhur me angazhime si “Procedurat administrative të procesit të dhënies së granteve të AMSHC do të përmirësohen brenda vitit 2025” apo “Funksionaliteti i plotë i platformës online për ndjekjen e procesit të granteve është do të aktivizohet brenda vitit 2025;

Komenti: ISP vlerëson se ekzistenca e AMSHC, funksionaliteti i tij dhe impakti lidhur me shoqërinë civile do të duhet të merret në shqyrtim, (ne bazuar në të dhënat tona mendojmë se është prej vitesh jo funksional dhe jo transparente), dhe se premtimi i përmirësimit të dhënies së granteve është tregues se sistemi aktual nuk është transparent. Platforma online është tregues formal dhe nuk sjell rritje të transparencës dhe as llogaridhënies në këtë rast.

XIII. Lidhur me pikën 3.2. Regjistri elektronik i OSHC-ve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është funksional brenda vitit 2023.

Komenti: ISP vlerëson se viti 2023 është mbyllur dhe ende ky regjistër nuk funksionon dhe nuk ka prova se ekziston si i tillë. Vendimi 35, datë 26.01.2022 i KLGJ ende nuk ka gjetur zbatim praktik.